



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 paragrafi I nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi nga fshati, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-5598 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-5598/1 me datë 11.12.2019, dorëzuar nga parashtruesi nga fshati,
NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprimi të mëtutjeshëm në lëndën me numër 12-5598 nga viti 2019, në rastin e lëndës nuk është vepruar nga ana e KSHPK për lëndën e formuar pas denoncimit me të njëjtat akuza të lëndës e cila është parashtruar nga njëjti parashtrues.

Lënda me numër 12-5598 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-5598 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-5598/1 me datë 11.12.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtruesi nga fshati

Në denoncim flitet për akuza kundër personave dhe, ish drejtor dhe drejtor aktual i gjimnazit, për punën e tyre të parregullt dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe funksionit. Në denoncimin e parashtruar janë numëruar disa akuza, të cilat parashtruesi i numëron sipas njohurive të veta dhe për akuza të cilat i ka ndëgjuar nga persona tjerë, për keqpërdorime të bëra nga ana e personave të denoncuar derisa e kanë kryer funksionin e drejtorit në gjimnazin, dhe atë: keqpërdorim të mjeteve financiare për mirëmbajtje të gjimnazit; parregullsi në shpërndarjen e profesorëve nga njëra në tjetrën shkollë të mesme në bazë të plotësimit të fondit të orëve; keqpërdorime të fondeve të orëve private të cilat i kanë realizuar profesorët kurse të hollat i ka fituar shkolla; parregullsi në emërimin e ndihmës drejtorit; shpërndarje jologjore të kontabilistëve në shkollë; tolerimi i mungesës me pagesë të profesorëve të cilëve iu është bërë pagesa e rrogës kurse mungesa është shfrytëzuar për punë të tyre jashta vendit; llogaritje jo e rregullt e fondit të orëve të kontabilistëve; vendosje të pabazë të ish drejtorit pas përfundimit të mandatit në vendin e punës bibliotekist në shkollën e njëjtë në të cilën nuk është paraparë diçka e tillë dhe borxh të madhë të shkollë të bërë gjatë kohës së drejtorimit të tyre.

Denoncimi i parashtruar është titulluar për Prokurorin publik në dhe në të kërkohet të ngritet procedurë gjyqësore kundër personave të denoncuar nëse vërtetohet akuizat e lëndës, kurse në denoncim thuhet se denoncimi i njëjtë është dorëzuar edhe në KSHPK, tek kryeministri dhe MPB – polici.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, Komisioni shtetëror i merr parasysh akuzat e parashtrusit dhe konstaton se nga ana e KSHPK vetëmse është vepruar për akuzat e lëndës së njëjtë të formuar pas denoncimit identik i cili është parashtruar nga parashtruesi i njëjtë nga fshati Lëndën për të cilën vetëme është vepruar nga ana e KSHPK është e vulosur me numër 12-5547 të viti 2019 dhe është formuar pas denoncimit me nr. 12-5547 me datë 10.12.2019, në të cilën flitet për akuza kundër personave dhe ish drejtor dhe drejtor aktual të gjimnazit për punën e tyre të parregullt dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe funksionit. KSHPK në vazhdimin e seancës së 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020, gjatë vprimit të tyre kompetent morri vendim me të cilën procedura për lëndën me numrë 12-5547 nga viti 2019, e formuar pas denoncimit 12-5547/1 me datë 10.12.2019, dorëzuar nga parashtruesi nga fshati, NDËRPRITET, përshkak se KSHPK vërtetoi se për rastin e lëndës vepron organ tjetër kompetent – PTHP, para të cilës procedura ende është në rrjedhë, me çka KSHPK vlerëson se Komisioni shtetëror nuk ka elemente për veprim të tij mëtutjeshëm në rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet. Vendimi i KSHPK është e vulosur me numrin e arkivës 12-1913/3 me datë 16.12.2020 dhe e njëjta me sqarimin – në formë të depersonalizuar, është e publikuar në web-afqen e Komisionit shtetëror në afatin e paraparë ligjor, kurse deri tek parashtruesi i denoncimit është dorëzuar Vendimi i KSHPK, me sqarimin. Në bazë të tërë të konstatuarës më sipër, Komisioni shtetëror vlerëson se nuk ka elemente për veprim të tyre të mëtutjeshëm në rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet, kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi
Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: J. C., këshilltarë
Miratoi: V. G., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР ПËР
PARANDALIM ТË KORRUPTIONIT**
Kryetarë: Biljana Ivanovska